

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA FIER

Nr. 7332. Prot.

PROJEKT-VENDIM NR. 61 dl 18 /06/2025

Për miratimin e tabelës me të dhënat e listës emërore të pronave dhe pronarëve, që do të shpronësohen për interes publik, për pasuritë e paluajtëshme pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Për zgjerimin i sheshit të stacionit zjarrfikës, të ndërtuar dhe financuar nga PNUD(UNDP), vlerësim paraprak, me qëllim mbulimin e vlerës paraprake të shpronësimit për interes publik nga Buxheti i Bashkisë Fier, për vijimin e proçedurave të shpronësimit për interes publik".

Këshillit të Bashkisë Fier, sot më dt..../.2025, i paraqitet për shqyrtim materiali nga komisioni i shpronësimit dhe vlerësimit paraprak, pranë Bashkisë Fier, ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Nr.340, datë 18/07/2024, në kuadër të realizimit të projektit të miratuar "Për zgjerimin i sheshit të stacionit zjarrfikës, të ndërtuar dhe financuar nga PNUD(UNDP)", në lidhje me listën emërore të pronave dhe pronarëve, pasuritë e paluajtshme pronë private , që shpronësohen për interes publik, vlerësim paraprak, (tabelë sipas formatit tip), më qëllim mbulimin e vlerës paraprake të shpronësimit nga Buxheti i Bashkisë Fier, si kërkesë ligjore për vijimin e proçedurave administrative-ligjore të shpronësimit për interes publik pranë ASHSH, MIE, Tiranë. Evidentimi i pasurive të paluajtshme si dhe vlerësimi paraprak i pasurive të paluajtshme pronë private , të llojit Truall", dhe "Ndërtesë" që preken nga gjurma e zbatimit të projektit, është bërë bazuar në kartelat e pasurisë së paluajtshme si dhe në statusin juridik, të konfirmuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier.

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9 Pika 1.2, gërma "b", Ligjin Nr.8561, datë.22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, VKM nr.89, datë 03/02/2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", VKM.138, datë 23.03.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë për interes publik", i ndryshuar bazuar në nenin 54, gërma "k", ekzekutivi i Bashkisë Fier :

Propozon :

1. Të miratojë tabelën me të dhënat e listës emërore të pronave dhe pronarëve, për pasuritë e paluajtshme pronë private, që do të shpronësohen për interes publik, *sipas tabelës bashkëlidhur;*

2.Vlera paraprake e shpronësimit për interes publik do të përballohet nga Buxheti i Bashkisë Fier për vitin 2025;

3.Për vazhdimin e mëtejshëm të proçedurave ligjore të shpronësimit për interes publik në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Sektorin e Shpronësimeve, Tiranë ngarkohet ekzekutivi i Bashkisë Fier.

Konc. Komisioni i shpronësimit dhe vlerësimit paraprak

Ermioni Gazeli

Eriona Llupi

Klajdi Hodaj

Jetion Gjeka

Ilsidor Prifti

Dr. Financë Buxhetit dhe Kontabilitetit P.Çina

> KRYETAR Armando Subashi



Adresa: Lagija "Kastriot", Rruga "Ramiz Aranitasi", Nr.15 Fier - SHQIPERI Tel. + 355 34 410650, www.bashkiafier.gov.al